AKTUALITET | LAJM KRYESOR

Arrestohet roja i sigurisë që dhunoi një qytetar gjatë tubimit në Zvërnec, hetim disiplinor policisë Vlorë

LAJMI I FUNDIT

19:57 **Aksident në aksin Laç-Patok, makina përplas për vdekje 37-vjeçarin me motor! Arrestohet shoferja**

19:48 **Vidhet sërish banania 5.8 milionë euro e Maurizio Cattelan, muzeu ngre padi**

31 Maj 2026 | 09:09

SHPËRNDAJE ARTIKULLIN

Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit ka njoftuar se është identifikuar, kapur dhe arrestuar punonjësi i shoqërisë private të sigurisë së kantierit, i cili shfaqet në pamjet filmike duke goditur me grusht shtetasin E. S gjatë tubimit një ditë më parë në Zvërnec.

Sipas Policisë së Shtetit, në vijim të veprimeve hetimore u bë identifikimi dhe shoqërimi i punonjësit të shoqërisë private të sigurisë, shtetasit Gerald Biba, 32 vjeç, banues në Durrës. Në përfundim të veprimeve të para hetimore, ai u arrestua në flagrancë, i dyshuar për veprat penale “Heqja e paligjshme e lirisë” dhe “Plagosja e lehtë me dashje”.

Nga hetimet paraprake rezulton se ky shtetas ka goditur me grusht shtetasin E. S. dhe më pas, në bashkëpunim me shtetasit A. G. dhe G. V., të cilët janë proceduar penalisht, e kanë tërhequr me forcë drejt vendit të rezervuar për rojet, duke i shkaktuar dëmtime të lehta trupore.

Ndërkohë, paralelisht me veprimet hetimore, Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit ka urdhëruar Drejtorinë e Standardeve Profesionale për nisjen e menjëhershme të hetimit disiplinor ndaj të gjithë zinxhirit komandues të DVP Vlorë, në lidhje me masat e marra dhe menaxhimin e tubimit të zhvilluar një ditë më parë.

Shiko në:

penale

19:46 **Papa Leo emëron gruan e parë laike në një pozicion të lartë në Vatikan**

19:43 **Botërori 2026 pritet të sjellë fitime rekord në SHBA**

19:39 **Rama: Në Shqipëri nuk ka të burgosur politikë, çështja e Veliajt nuk është çështja jonë**

19:33 **Hoxha pret Kos dhe ekipin e BE në misionin shqiptar në Bruksel: Vlerësimi i IBAR reflekton përpjekjet transformuese**

LAJME TË SUGJERUARA

AKTUALITET | VENDI

Aksident në aksin Laç-Patok, makina përplas për vdekje 37-vjeçarin me motor! Arrestohet shoferja

Një aksident i rëndë është regjistruar këtë të martë në aksin Laç-Patok ku për pasojë ka humbur jetën një 37-vjeçar. Policia bën me dije se...

19:57 | 02/06/2026

AKTUALITET | POLITIKË

Rama: Në Shqipëri nuk ka të burgosur politikë, çështja e Veliajt nuk është çështja jonë

Partia Socialiste feston 35-vjetorin e themelimit në Tiranë. Në këtë organizim janë mbledhur mjaft socialistë dhe drejtues të PS, me në krye Edi Rama. Kryeministri...

19:39 | 02/06/2026

AKTUALITET | POLITIKË | VENDI

Hoxha pret Kos dhe ekipin e BE në misionin shqiptar në Bruksel: Vlerësimi i IBAR reflekton përpjekjet transformuese

Ministri për Evropën dhe Punët e Jashtme, Ferit Hoxha përmes një postimi postim në 'X' njoftoi se këtë të martë zhvilloi një takim me kolegë...

19:33 | 02/06/2026

Copyright © Euronews 2026